

VENDIM
Nr. 137, datë 15.8.2016

MBI KËRKESËN E OST SHA LIDHUR ME MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E TRANSMETIMIT PËR PERIUDHËN E MBETUR TË VITIT 2016

Në mbështetje të nenit 10, pika 2, dhe 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.8.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike mbi kërkesën e OST sh.a., lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit për periudhën e mbetur të vitit 2016,

konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a., me anë të shkresës nr. 4207 prot., datë 17.7.2016, i është drejtuar ERE-s, lidhur me trajtimin e mbulimit të humbjeve në rrjetin e transmetimit, për periudhën e mbetur të vitit 2016.

- MEI, me shkresën nr. 4514/1 prot., datë 3.8.2016, ka dërguar në ERE qëndrimin e saj lidhur me kërkesën e OST sh.a. për lënien të pandryshuar edhe për 6-mujorin e dytë të vitit 2016 të çmimit të energjisë elektrike që OST sh.a. i paguan KESH sh.a. për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit.

- ERE bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për energjinë dhe me institucionet e tjera publike, për sa u takon çështjeve objekt të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, që janë në fushën e përgjegjësisë së tyre.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Për qëllime të prokurimit të humbjeve në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, për periudhën e mbetur të vitit 2016, duke filluar nga 1.8.2016–31.12.2016, OST sh.a. të sigurojë humbjet nga KESH sh.a. në përputhje me përcaktimet e kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit”, miratuar me vendimin nr. 78, datë 7.6.2016, të Bordit të ERE-s.

2. Pika 3 e vendimit nr. 102, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, “Për miratimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat”, shfuqizohet.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a. dhe KESH sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

